

VENDIM
Nr. 108, datë 29.6.2016

**MBI KËRKESËN E SHOQATËS SHQIPTARE TË ENERGJISË SË
RINOVUESHME PËR RISHIKIMIN/PEZULLIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË
ERE-s NR. 77, DATË 7.6.2016, “PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN
E RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 16, pika 4 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.6.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi kërkesën e shoqatës shqiptare të energjisë së rinovueshme “AREA”, për rishikimin/pezullimin e vendimit nr. 77, datë 7.6.2016, të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Në nenin 108, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se “Ngarkohet ERE që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji... të miratojë me propozimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, rregullat e tregut të energjisë elektrike.”

- Nuk është paraqitur asnjë provë e re, për të mbështetur kërkesën për rishikim/pezullimin e procedurave të miratimit të “Rregullave të tregut.”

- Shoqata “AREA” nuk përfaqëson palë interesi, të legjitimuar për të kërkuar rishikimin e një vendimi të Bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqatës shqiptare të energjisë së rinovueshme “AREA”, për rishikimin/pezullimin e vendimit nr. 77, datë 7.6.2016, të Bordit të ERE-s, “Për fillimin e procedurave për miratimin e rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë AREA-n, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti